



KENGO KUMA AND ASSOCIATES, FITUESI I KONKURISIT NDËRKOMBËTAR PËR QENDRËN E VIZITORËVE NË BUTRINT

Kengo Kuma and Associates u shpall fituese e Konkursit Ndërkombëtar mes 4 studiove të arkitekturës për hartimin e projektit për Qendrën e Vizitorëve në Parkun Kombëtar të Butrintit. Për qasjen unike arkitekturore në krijimin jo thjesht të një objekti, por të një porte hyrëse në pasurinë e Butrintit, me një pamje të mrekullueshme dhe krijimin e një hapësire publike takimi për komunitetin lokal dhe turistët, mes katër studiove finaliste:

- Kengo Kuma & Associates (Japoni)
- Lahdelma & Mahlamäki Architects (Finlandë)
- Philippe PROST / AAPP (Francë)
- William Matthews Associates (Mbretëria e Bashkuar), juria përzgjedhi si fituese studion Kengo Kuma & Associates (Japoni). Procesi i seleksionimit dyfazësh u organizua nga Malcolm Reading Consultants në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës së Shqipërisë dhe Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit. Konkursi u financua nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan

KENGO KUMA AND ASSOCIATES U SHPALL FITUESE E KONKURISIT NDËRKOMBËTAR MES 4 STUDIOVE TË ARKITEKTURËS

për ZhvillimThe_AADF. Juria e përbëhej nga: Elva Margariti, kryetare e bordit të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, Ministre e Kulturës, Shqipëri;

Martin Mata, Bashkë-CEO, Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për ZhvillimThe_AADF; Aleksandër Sarapuli, Bashkë-CEO, Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim;

Róisín Heneghan, Bashkë themeluese dhe Drejtuese e 'Architects Heneghan Peng'; Mónica Luengo Anón, Themeluese, "Arkitekturë, Territor dhe Peizazh, ATP"; Suzanne Ogge, Drejtuese e Projekteve dhe Trashëgimisë Ndërkombëtare, studio Milou, dhe konsulente e UNESCO; Thomas Vonier, Ish-kryetar i Unionit Ndërkombëtar të Arkitektëve, partner i Chesapeake Strategies dhe Matilda Pando, Kryetare e Shoqatës së Arkitektëve të Shqipërisë dhe themeluese e MATT Architects.



RESTAUROHEN KISHAT NË FINIQ E DELVINË

Kanë filluar punimet e mirëmbajtjes, restaurimit, konsolidimit në monumentin e kulturës së kat. I, në kishën e Shën Mëhillit, e cila ndodhet në Kostar të Bashkisë së Finiqit, si dhe në kishën e Shën Janit, monument kulture, kat. I, në Bashkinë Delvinë. Pas hartimit të projektit nga DRTK Vlorë dhe miratimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, kanë nisur punimet që konsistojnë kryesisht në: restaurimin dhe konsolidimin e muraturës së rrënojave të kishës; restaurimin e kall-drëmit të kishës; konsolidim i elementeve konstruktive; restaurim i elementeve dekorative në muraturë; sistemimin e terrenit etj.



"SAMSONI DHE DALILA" U NGJIT PREMIERË NË SKENËN TEATRIT TË OPERËS

Opera "Samsoni dhe Dalila" u ngjit për herë të parë në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor. Një nga historitë më të njohura biblike erdhi përmes interpretimit të solistëve Vikena Kamenica, Armando Likaj, Dario di Vietri, korit nën drejtimin e Dritan Lumshit, Orkestrës Simfonike nën drejtimin e dirigjentit Marco Attura, regjisorit Paul-Emile Fourny, me kostumografi nga Berina Kokona dhe skenografi nga Genc Shkodrani. "Samsoni dhe Dalila" erdhi si një bashkëpunim i TKOBAP, Teatrit të Operës së Metsit, Francë dhe Konservatorit të Salernos, Itali.

MIRATOHET FONDI PËR NDËRHYRJEN EMERGJENTE NË URËN E ZOGUT

Qeveria shqiptare miratoi fondin prej 57,5 milionë lekësh, që mundëson zbatimin e projektit për ndërhyrjen emergjente në këtë objekt, i cili pësoi dëmtime të rënda për shkak të reshjeve të disa muajve më parë. Pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale të projektit të ndërhyrjes emergjente në Urën e Matit, nën kujdesin e zv.kryeministres, znj. Belinda Balluku, u mblodh dhe u angazhua Komiteti Mbrojtjes Civile, me qëllim sigurimin e fondit të nevojshëm për zbatimin e tij. Projekti është rezultat i një pune profesorësh e ekspertësh të nderuar të Fakultetit të Inxhinierisë në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore që, me urdhrin e kryeministrit, u bënë bashkë për hartimin e projektit, brenda një kohe të shkurtër, me shumë përgjegjësi e profesionalizëm. Miratimi i projektit u parapri nga vendosja e pajisjeve monitoruese, për të mundësuar të dhënat teknike e shkencore për hartimin e projektit të zbatimit.



SHQIPËRIA DHE KOSOVA NË PANAIRIN E LIBRIT NË LEIPZIG

Pas tri vitesh mungesë, për shkak të pandemisë, u rikthye për lexuesin një nga ngjarjet më të mëdha të librit. Mijëra vizitorë ndoqën panairin pjesë e të cilit ishte edhe Shqipëria me stendën e saj, falë bashkëpunimit me rrjetin Traduki dhe mbështetjen e Ministrisë së Kulturës të Shqipërisë. Një sërë aktivitetesh mbi letërsinë bashkëkohore u organizuan nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit. Të pranishëm ishin autorët Lindita Arapi, Arian Leka, Ag Apolloni, Loer Kume, Andreas Dushi, Flogerta Krypi, Ervin Nezha, Stefan Çapaliku, Ana Kove etj. E ardhmja përmes librit erdhi në refleksionet e autorëve të rinj shqiptarë përballë një audience të gjerë. Ndërsa u diskutua edhe për letërsinë si formë komunikimi mes kulturave të ndryshme. I pranishëm në aktivitetet ishte edhe ambasadori i Shqipërisë në Gjermani, Artur Kuko.

PAS 3 VITESH

U RIKTHYE PËR LEXUESIN NJË NGA NGJARJET MË TË MËDHA TË LIBRIT. MIJËRA VIZITORË NDOQËN PANAIRIN PJESË E TË CILIT ISHTE EDHE SHQIPËRIA ME STENDËN E SAJ

SHPALLEN FITUESIT E FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR TË RINJ

Fondi i Krijimtarisë Letrare për të Rinj çdo vit u jep mundësinë 3 autorëve të rinj të botojnë veprat e tyre të para. Bashkë me ministren e Kulturës znj. Elva Margariti, shkrimtarë, botues të pranishëm, ndanë vlerësimet për fituesit e këtij viti: Alban Tufa, Enxhi Naumi, Andrin Kabashi. Juria e kryesuar nga Liridon Mulaj dhe anëtarë Enkel Demi, Sonila Strakosha, vlerësoi mes 11 dorëshkrimeve krijimet e Alban Tufës me dorëshkrimin "Ata ishin (mbetën) dy", shtëpia botuese "Toena" me motivacionin "Për origjinalitetin dhe thellësinë e vargut poetik të shprehur me sinqeritet dhe pjekuri"; Enxhi Naumit me dorëshkrimin "Tytnia", shtëpia botuese "Albas" me motivacionin "Për poezinë e zhveshur nga droja duke e shpalosur sentimentin lakuriq nëpërmjet ndjeshmërisë së lartë artistike"; Andrin Kabashin me dorëshkrimin "Qyteti pa lumë", shtëpia botuese "Onufri" me motivacionin "Për mesazhet nënkuptimore të qercjella nëpërmjet një stili



ekzistencial dhe proze të konsoliduar, që evidentojnë problemet thelbësore të brezit të mileniumit të ri".